



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.31, Datë 21.02.2020

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE”
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “ç”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “d” nenit 5 pika 1 gërma “d” dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 21.02.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, me nr.30/1 Prot, datë, 07.02.2020, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se:

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., me shkresën nr. 24/20 Prot, datë 28.01.2020, protokolluar në ERE me nr. 246 Prot, datë 28.01.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 263, Seria FK15, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 8, datë 02.02.2015, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, deri më 11.02.2020.
- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 27.09.2014 është regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk), konform ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L42203031A.
- Objekt i veprimtarisë së saj është: Kryerja e aktivitetit të furnizimit dhe tregtimit në energji dhe mallra tregtare, si dhe aktivitete të tjera që lidhen me tregtimin e çertifikatave të gjelbra dhe të gazit etj.
- Aplikimi i shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, si më poshtë:
- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”). Plotësuar.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”), Plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”). Plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.7 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “d”, “f”. Plotësuar pjesërisht.
- Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar (neni 9, pika 4.7, gërma “b”, “c”). Plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me azhurnimin e dokumentacionit apo plotësimit të saktë të tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, që ka të bëjë me:

- Neni 9 pika 1 gërma “b”. (të dhëna identifikuese për aplikuesit). Shoqëria duhet të paraqesë bashkëlidhur autorizimin për të deleguarin përgjegjës/përfaqësuesin ligjor.
- Neni 9, pika 2 gërma “d” (Vërtetimin e Gjykatës dhe Prokurorisë për shoqërinë dhe administratorin e saj) do t’i kërkohet shoqërisë që të depozitojë në ERE, vërtetime të Prokurorisë dhe Gjykatës përkatësisht për administratorët, shoqërinë dhe përfaqësuesin ligjor.
- Neni 9, pika 3, gërma “d” (Vërtetim për kryerjen e pagesës së regjistrimit për aplikim) Detyrimi është shlyer pjesërisht.
- Neni 9, pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “h”, “i”: Plotësuar pjesërisht. Do t’i kërkohet shoqërisë që këtë informacion/dokumentacion t’a sjellë dhe në versionin hard copy, origjinal ose të njësuar me origjinalin, sipas kërkesave të nenit 8, pika 3, të rregullores gërma “e” (Sistemin IT). Pa plotësuar. Shoqëria nuk ka paraqitur ndonjë informacion /dokumentacion nëse është i certifikuar, nëse ka ndonjë kontratë ose marrëveshje për këtë kusht të rregullores etj. gërma “g” (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve). Shoqëria nuk ka paraqitur në ERE dokumentacion provues.

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, e ndryshuar t’i paraqesë, plotësojë apo saktësojë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI